



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Nr. Prot.: 817
Date: 29/3/2018

Në bazë të nenit 23, paragrafit 1.6, alineja 1.6.2 të Statutit të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", Këshilli Drejtues i Universitetit të Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 29.03.2018, miratoi:

RREGULLOREN

Për plotësim ndryshim të Rregullores nr. 2/486 të datës 11.9.2017 për të ardhura personale të personelit akademik, shtesat për funksione, honorarët dhe komisionet e përhershme në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina"

Neni 1

Neni 8 i rregullores bazike, pas paragrafit 2 plotësohet me dy paragrafë të ri si në vijim:

1. Kusht për shpalljen e konkursit për mësimdhënës është plotësimi i normës prej 6 orëve të ligjëratave në secilin semestër ose së paku tri (3) orë të ligjëratave nga lëndët obligative dhe pjesa tjetër e orëve të ligjëratave nga lëndët zgjedhore për secilin semestër.
2. Përrjashtimisht nga paragrafi 1 i këtij neni në Fakultetin e Mjekësisë lejohet shpallja e konkursit për mësimdhënës nëse ekzistojnë së paku tri (3) orë ligjëratave nga lëndët obligative dhe pjesa tjetër e orëve të ligjëratave nga lëndët zgjedhore ose deri në gjashtë (6) orë nga praktika klinike për secilin semestër.

Neni 2

3. Paragrafët tjerë të nenit 8 të rregullores bazike zhvendosen për dy paragrafë më poshtë, ndërsa teksti mbetet i pandryshuar.

Neni 3

Ndryshim plotësimet e nenit 8 të rregullores bazike hyjnë në fuqi nga dita e miratimit nga Këshilli Drejtues dhe do të jenë pjesë përbërëse të Rregullores nr. 2/486 të datës 11.9.2017 për të ardhura personale të personelit akademik, shtesat për funksione, honorarët dhe komisionet e përhershme në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina".

Ardiana Bunjaku
Kryesuese e Këshillit Drejtues